



KOMUNA E SHITES
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore në Komunën e Shtimes.

Në bazë të nenit 12 të Rregulorës MF Nr.04.2017 mbi kriteret, standardet, dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Shtimes u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinis dhe sportit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masovizimin e sportit, projektet rinore apo kulturore.
 2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:
 - 2.1. Të gjitha OJQ-të, Klubet Aktive Sportive në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e sportit,
 - 2.2. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës,
 - 2.3. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e Rinisë,
 3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e sektorit të kulturës, rinisë dhe sportit.
 4. Vlera totale e planifikuar, e thirrjes është: **30,000 Euro**
 - 4.1. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet është **200 Euro**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **10,000 Euro**
 5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është **15 ditë pune, nga data 13.03.2019.**
 6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti 2 projekte në kuadër të kësaj thirrjeje, por vetëm me një projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të thirrjes është deri në dhjetor. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes publike.
- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Shtimes, së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.
- OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe të sportit.
- OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e